



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.262/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje, paraqitur kundër Vesel Veselit për shkak të kërcënimit gjatë ditës së votimit në komunën e Mitrovicës, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 14.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.262/2017 e datës 12.06.2017 parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje

A r s y e t i m

Me datën 12.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje në të cilën theksohet se në qendrën e votimit 1004b në shkollën fillore “Ismail Qemajli” në Mitrovicë në afërsi të kësaj qendre të votimit Vesel Veseli ka dhënë ryshfet për të votuar koalicionin PAN. Sipas parashtruesit të ankese ky grup po ashtu ka kërcënuar me armë Dren Gashin koordinator i qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje në Mitrovicë i cili ka qene duke i shpërndarë ushqimin për komisionerët e LVV-së për këtë qendër të votimit, ku po ashtu ka pasur disa raportime që në afërsi të kësaj qendre të votimit ka pasur presion ndaj votuesve përgjatë gjithë periudhës sa ka vazhduar procesi i votimit.

PZAP-i me datën 13.02.2017 nëpërmjet telefonit zyrtar ne cilësinë e dëshmitarit mori deklaratën e Rexhep Kuqit menaxheri i kësaj qendre të votimit, ku i njejt i mohon se ka pasur parregullsi në këtë qendër dhe se gjithçka ka shkuar në rregull.

Lidhur me rastin ne fjale PZAP-i e njoftoi edhe Policinë e Kosovës dhe kërkoi nga ata që të ndërmarrin veprime konkrete.

Në raportin e policisë të datës 13.06.2017 të dorëzuar në PZAP theksohet se lidhur me rastin në fjale zyrtarët policor me datën 11.06.2017 kanë pranuar një telefonat ku pretendohet se një

person me emrin Dren Gashi është i kërcënuar prej Vesel Veselit, ku më pas Policia e Kosovës së bashku me prokurorin kujdestar kanë dalur në vendin e ngjarjes tek shkolla Ismail Qemajli në Mitrovicë ku me të mbërritur aty nuk kanë hasur në personin Vesel Veseli e as në palën ankuese Dren Gashi. Po ashtu në raportin e policisë theksohet se Policia e Kosovës ka kontaktuar edhe me menaxherin e kësaj qendre të votimit gjegjësisht drejtorin e shkollës Rexhep Kuqi ku sipas të njëjtit nuk ka pasur kurrfarë njohurish rreth kanosjes apo se dikush ka provuar që të jap rryshfet në shpërblim të votimit

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografisë së bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar:

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar ndonjë dëshmi apo provë materiale e cila do ti vërtetonte pretendimet ankimore edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 par.3 të LZP-së, për te provuar pretendimet ankimore. Paneli vlerësoi se ankesa është e pabazuar ngase nuk ka elemente të kërcënimit në rastin konkret dhe nuk ka persona të identifikuar nga Policia lidhur me pretendimet ankimore. Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 262/2017 më datën 14.06.2017



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.